



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 234 Prot.

Tiranë, më dt. 18.04 .2018

**VENDIM**

**Nr.211, dt. 18.04.2018**

Në mbështetje të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, dhe VKM nr.280, dt.01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar me VKM nr.756, dt.26.10.2016, si dhe Kodit të Proçedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 18.04.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e vazhdimit të proçedurave të legalizimeve për objektin “Banesë 2 kate + papafingo + podrum, në rrugën “Bardhyl Pojani” Korçë, me subjekt aplikues z. Ruben Balli, në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike Korçë.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR**

**Arta Dollani**

**KRYËTAR**  
**Mirela Kumbaro Furxhi**

